



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463-01/ 30146, dt. 29 Maj 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, nenit 15 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, nenit 253 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronën dhe të Drejtat Tjera Sendore, neneve 26 dhe 27 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, si dhe nenit 19 të Statutit të Komunës së Pejës Nr. 01/2020, Drejtoria për Çështje Pronësore, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 10-352/01-68074, datë 28.08.2025, të parashtruar nga shoqëria “Dukagjin Solar Sverke 04 L.L.C.”, Kuvendi i Komunës Pejë, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, në takimin e mbajtur me datë: dt. 29 Maj 2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Nr. 34/2026

Mbi miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e Servitutes Reale për instalimin e kabllor nëntokësorë, ZK Sferkë në pronësi të Komunës së Pejës

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për themelimin e servitutës reale mbi pronat e paluajtshme komunale: P-71611080-00271-1, P-71611080-00275-0, P-71611080-00276-0, P-71611080-00219-0, zona kadastrale Sverkë, në pronësi të Komunës së Pejës, sipas elaboratit teknik dhe dokumentacionit përcjellës, për realizimin e projektit të instalimit të linjës kabllorë nëntokësore deri në 35 kV dhe kabllor me fibra optike, në kuadër të projektit “Parku Solar Sverkë”, nga Shoqëria “Dukagjin Solar Sverke 04 L.L.C.”, me numër unik identifikues 812061026.

ANEKSI I – SERVITUTA

Nr. Pronari	Njësia Kadastrale	Gjatësia (m')	Sipërfaqja (m ²)
1 Komuna e Pejës	P-71611080-00271-1	1,223	733.80
2 Komuna e Pejës	P-71611080-00275-0	152	91.20
3 Komuna e Pejës	P-71611080-00276-0	142	85.20
4 Komuna e Pejës	P-71611080-00219-0	84	50.40

Totali: 1,601 m' — 960.60 m²

BASHKËNGJITUR

- Kërkesa e palës nr. 10-352/01-68074, datë 28.08.2025.
 - Elaborati i servitutës.
 - Projekti teknik.
 - Pëlqimi nr. 10/352/01-21162, datë 06.05.2025.
 - Certifikatat pronësore .
 - Hartat dhe skicat teknike.
- II. Për themelimin e servitutës reale mbi pronat e paluajtshme komunale pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik, elaboratit të servitutës dhe pëlqimit nr. 10/352/01-21162, datë 06.05.2025, është konstatuar se:
- infrastruktura energjetike kalon ekskluzivisht nëpër parcela komunale përgjatë korridorit rrugor;
 - gjatësia e përgjithshme e trasës është 1,601 metra me gjerësi 0.60 m;
 - sipërfaqja totale e ngarkuar me servitutë është 960.60 m²;
 - shtrirja, koordinatat dhe specifikimet teknike janë të përcaktuara në projektin teknik dhe elaboratin e servitutës (Aneksi I);
 - instalimi i kabllor është i domosdoshëm për funksionimin e projektit energjetik “Parku Solar Sverkë”, i cili paraqet infrastrukturë me interes publik.
- III. Në bazë të nenit 27 të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, për këtë servitutë nuk parashihet kompensim financiar, duke qenë se bëhet fjalë për infrastrukturë energjetike me interes publik dhe vendoset në pronë komunale.
- IV. Servituta propozohet të vendoset për aq kohë sa infrastruktura energjetike mbetet funksionale.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohet që të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro-Juridike.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në web faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj